



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

NR 12048 PROT
DATA 14/12/2019



Nr _____ prot

Korçë më ___/___/___

BASHKIA KORÇË

RELACION

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR 158 DATË 26.11.2024 PËR “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025”

Mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, në ligjin nr 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin Nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, ligjin nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar propozojmë të bëhen disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 158 datë 26.11.2024 “Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundrvajtjet administrative për vitin 2025” si më poshtë:

- Propozim për përjashtim nga pagesa e tarifave për vitin 2025 të gjithë subjektet që do të hapin për herë të parë aktivitetin e tyre tek Pazari i Vjetër i qytetit si dhe pagesa e tarifave vendore (pastrim, ndriçim dhe gjelbërim) në masën 50% për këto subjekte të cilat do e vazhdojnë aktivitetin e tyre dhe në vitin pasardhës
- Propozim për shtim të disa kategorive dhe miratim të nivelit në llojet dhe nivelet e gjobave që do të vendosen nga Policia Bashkiake në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative

Propozim për përjashtim nga pagesa e tarifave për vitin 2025 të gjithë subjektet që do të hapin për herë të parë aktivitetin e tyre tek Pazari i Vjetër i qytetit si dhe pagesa e tarifave vendore (pastrim, ndriçim dhe gjelbërim) në masën 50% për këto subjekte të cilat do e vazhdojnë aktivitetin e tyre dhe në vitin pasardhës

Referuar propozimit të disa këshilltarëve në mbledhjen e këshillit të bashkisë datës 26.11.2024 në lidhje me krijimin e lehtësive për subjekte të cilat do të ushtrojnë rishtaz aktivitet në pazarin e vjetër të qytetit. Bashkia Korçë me qëllimin për zhvillimin e mëtejshëm të zonës që tashmë është një pol i rëndësishëm ekonomik - turistik, si dhe duke pasur në fokus rritjen e shërbimeve, promovimin e zonës, zhvillimin e aktiviteteve dhe eventeve të ndryshme në këtë zonë propozojmë që për të gjitha ato subjekte të cilat do të ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre tek Pazari i Vjetër i qytetit të përjashtohen nga pagesa e tarifave (pastrim, ndriçim dhe gjelbërim)

për vitin 2025 si dhe pagesa e tarifave vendore (pastrim, ndriçim dhe gjelbërim) për subjektet të cilat do ta vazhdojnë aktivitetin në vitin pasardhës të jetë në masën 50%. Në këtë fashë do të përfshihen të gjitha subjektet të cilat do të ushtrojnë aktivitetet në njësitë tregëtare të cilat nuk kanë qënë në aktivitet për një periudhë paraardhëse 2 vjeçare.

Propozim për shtim të disa kategorive dhe miratim të nivelit në llojet dhe nivelet e gjobave që do të vendosen nga Policia Bashkiake në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative

Në zbatim të detyrave funksionale, informatizimit të Drejtorisë së Policisë Bashkiake nëpërmjet përdorimit dhe aksesimit të pjesshëm të sistemit digital e-gjoha të marrjes së masave Administrative , sistemin tims, zbatimit të kuadrit ligjor konkretisht ligjit Nr.89/2022 "Për Policinë Bashkiake", Neni 9 "Kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake" dhe Neni 10 të ligjit për "Kundërvajtjet administrative" propozojmë shtimin në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 158 datë 26.11.2024 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2025" të disa llojeve të kundërvajtjeve administrative dhe nivelit që do të aplikohet për to . Të ardhurat nga masat administrative me gjobë për shkeljet e parashikuara paguhen nga kundërvajtësi brenda 15 ditëve nga dita që gjoba regjistrohet ose vendimi ka marrë formën e prerë. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet 2 për qind kamatë deri në një muaj. Në të gjitha rastet e parashikuara me gjobë, nëse arkëtimi i vlerës së gjobës nga kundërvajtësi bëhet brenda 15 ditëve nga dita që gjoba regjistrohet ose vendimi ka marrë formë të prerë, gjoba ulet me 50 për qind të vlerës.

Mbështetur tek marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Korçë për "Vjeljen e detyrimeve të pashlyera nga kundërvajtjet rrugore dhe konvertimin e këtyre vlerave monetare në investim për Policinë e Shtetit" , Bashkia Korçë bazuar në kuadrin ligjor do të përkthejë në investim për Policinë e Shtetit 25% të vlerës së gjobave të arkëtuara për llogari të Policisë Bashkiake. Kjo përqindje do ti kalojë Policisë së shtetit në formë investimi, kryesisht në fushën TIK.

Referuar sa më sipër propozojmë:

GJOBAT PËR SHËRBIMIN NË TRANSPORTIN E UDHËTARËVE

PËRSHKRIMI	Tarifa
Drejton mjetin i pa paisur me liçencë për taks	5,000 - 20,000 lekë
Drejton mjetin taks i jo në përputhje me normat në fuqi ose me kushtet e përcaktuara në liçencë	5,000 - 20,000 lekë
Përdor mjetin, në linjë të ndryshme nga ajo për të cilën është liçencuar	5,000 - 20,000 lekë
Parkon mjetin në një zonë ku parkimi lejohet për një kohë të kufizuar, pa zbatuar sistemin e kohëzgjatjes së parkimit	500 - 3,000 lekë

GJOBAT PËR PARKIMIN

PËRSHKRIMI	TARIFA
Pushon mjetin në një zonë urbane për këmbësorë	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në një hapësirë të rezervuar për pushimin e mjeteve për invalidë	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në hapësirë të rezervuar për mjete taksi	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në hapësirë të rezervuar për autobuzë	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në një largësi me të vogël se 15 metra sinjali i stacionit	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin përpara kasave të mbeturinave urbane	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në korsin të dedikuar për mjete publike	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në trotuar	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në bashkimet e rakorduara ndërmjet trotuareve	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në rrugëkalim dhe vendkalim për këmbësorë	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në korsin të dedikuar për bicikleta	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në dalje/hyrje të korsisë për bicikleta	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në hapësirë të rezervuar për mjete e shkarkimit të mallrave	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në një zonë me trafik të kufizuar për mjete të pa autorizuara përveç (rezident/ subjekt)	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në tabelë ndalim qarkullimi	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin pa përdorur sistemin e kufizimit të parkimit	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në rrugëkalim mjetesh duke penguar rrjedhjen e lirë të trafikut	1,000 - 3,000 lekë

Drejtores e Drejtorisë së Përgjithshme
Juridike dhe të Menaxhimit
të Burimeve Njerëzore

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

Policia Bashkiake

Erald Kreka

Drejtores e Taksave dhe Tarifave Vendore

Soniell Prifti

KRYETARI I BASHKISË

Sotiraq FILO

Në mungesë dhe me urdhër

Zv/Kryetar

Besa Spaho



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË**

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR 158 DATË 26.11.2024 PËR
“NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË
BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Burimeve Njerëzore dhe Policia Bashkiake, bazuar në Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, në ligjin nr 8378, datë 22.07.1998 “Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në ligjin Nr.89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, ligjin nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve të anëtareve.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Të miratojë, shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 153 datë 07.12.2023 për “NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË E KORÇËS SI DHE PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2024” si më poshtë:

Në Kapitullin IV, Tarifat Vendore, Lehtesi dhe perjashtime.

Të shtohet:

- **Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2025 të gjithë subjektet që do të hapin për herë të parë aktivitetin e tyre tek Pazari i Vjetër i qytetit si dhe pagesa e tarifave**

vendore (pastrim, ndriçim dhe gjelbërim) në masën 50% për këto subjekte të cilat do e vazhdojnë aktivitetin e tyre dhe në vitin pasardhës

Në llojet dhe nivelet e gjobave që do të vendosen nga policia bashkiake në rastet e shkeljeve dhe kundërvajtjeve administrative

Të shtohet:

GJOBAT PËR SHËRBIMIN NË TRANSPORTIN E UDHËTARËVE

PËRSHKRIMI	Tarifa
Drejton mjetin i pa paisur me liçencë për taksi	5,000 - 20,000 lekë
Drejton mjetin taksi jo në përputhje me normat në fuqi ose me kushtet e përcaktuara në liçencë	5,000 - 20,000 lekë
Përdor mjetin, në linjë të ndryshme nga ajo për të cilën është liçencuar	5,000 - 20,000 lekë
Parkon mjetin në një zonë ku parkimi lejohet për një kohë të kufizuar, pa zbatuar sistemin e kohëzgjatjes së parkimit	500 - 3,000 lekë

GJOBAT PËR PARKIMIN

PËRSHKRIMI	TARIFA
Pushon mjetin në një zonë urbane për këmbësorë	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në një hapësirë të rezervuar për pushimin e mjeteve për invalidë	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në hapësirë të rezervuar për mjete taksi	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në hapësirë të rezervuar për autobuzë	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në një largësi me të vogël se 15 metra sinjali i stacionit	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin përpara kasave të mbeturinave urbane	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në korsin të dedikuar për mjete publike	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në trotuar	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në bashkimet e rakorduara ndërmjet trotuareve	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në rrugëkalim dhe vendkalim për këmbësorë	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në korsin të dedikuar për bicikleta	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në dalje/hyrje të korsisë për bicikleta	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në hapësitë të rezervuar për mjete e shkarkimit të mallrave	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në një zonë me trafik të kufizuar për mjete të pa autorizuara përveç (rezident/ subjekt)	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në tabelë ndalim qarkullimi	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin pa përdorur sistemin e kufizimit të parkimit	1,000 - 3,000 lekë
Pushon mjetin në rrugëkalim mjeteve duke penguar rrjedhjen e lirë të trafikut	1,000 - 3,000 lekë

- Të ardhurat nga masat administrative me gjobë për shkeljet e parashikuara paguhen nga kundërvajtësi brenda 15 ditëve nga dita që gjoba regjistrohet ose vendimi ka marrë formën e prerë. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë, paguhet 2 për qind kamatë deri në një muaj. Në të gjitha rastet e parashikuara me gjobë, nëse arkëtimi i vlerës së gjobës nga kundërvajtësi bëhet brenda 15 ditëve nga dita që gjoba regjistrohet ose vendimi ka marrë formë të prerë, gjoba ulet me 50 për qind të vlerës.
- Mbështetur tek marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Korçë për “ Vjeljen e detyrimeve të pashlyera nga kundërvajtjet rrugore dhe konvertimin e këtyre vlerave monetare në investim për Policinë e Shtetit” , Bashkia Korçë bazuar në kuadrin ligjor do të përkthejë në investim për Policinë e Shtetit 25% të vlerës së gjobave të arkëtuara për llogari të Policisë Bashkiake. Kjo përqindje do ti kalojë Policisë së shtetit në formë investimi, kryesisht në fushën TIK.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake sipas funksioneve që kanë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

K R Y E T A R

Eva NAÇI

Ana Verushi

Miraturar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____